

6816

VENDIM

**PER RIREGJISTRIM TE FIRMES SICAI Ltd. nr 7947 date 24.09.1992 NE
SHOQERI TREGETARE SICAI Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date _____, une gjyqtarja _____, mbasi u njoha me materialet e paraqitura nga z.Plarent Kristo, administrator i Shoqerise Tregetare SICAI Sh.p.k. per riregjistrimin e Firmes SICAI Ltd., regjistruar me vendim te Gjykates se Rrethit te Tiranes me nr.7947 date 24.09.1992

KONSTATOVA

Kerkesa e paraqitur nga Kerkuesi per riregjistrimin e Firmes SICAI Ltd. duke marre formen e nje Shoqerie Tregetare me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare ", mbasi formularet e regjistrimit dhe kushtet materiale nuk i ka ne perputhje me kete ligj, eshte e drejte dhe ne baze te ligjes duhet pranuar.

Gjithashtu, kerkohet qe te behen disa ndryshime si me poshte:

1. Pranimin e doreheqjes se z.Paolo Bulzacchi si president i firmes SICAI Ltd. dhe largimin e tij si ortak nga kjo firme.

2. Pranimin e doreheqjes se z.Luan Leka si drejtor i firmes SICAI Ltd. dhe largimin e tij si ortak nga kjo firme.

3. Pranimin e z. Plarent Kristo si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 7% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

4. Pranimin e z. Roland Joti si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 7% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

5. Pranimin e z. Thomas Untersteiner (shtetas austriak) si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 34% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

6. Ndryshimin e kontributit te Z. Grigot Joti ne kapitalin themeltar te Shoqerise SICAI Sh.p.k. nga 33% ne 52%.

7. Ndryshimin e dokumentave baze te firmes ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe riregjistrimin e saj ne organet perkatese me kete objekt veprimtarie :

- Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice.
- Tregetim artikujsh industriale me shumice e pakice.

16

- Eksport-Import produktesh ushqimore e artikujsh industriale.
- Funkcionim i nje lokali Bar-Bufe.
- Komisioneri.
- Konsulenca.

Selia e Shoqerise do te jete Rr. Mihal Duri, Nr 17, Tirane.

Jetegjatesia e Shoqerise do te jete 49 vjet.

Emertimi i Shoqerise do te jete si me poshte :

Shoqeria tregetare SICAI Sh.p.k.

si dhe regjistrimin e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregetar te Gjykates.

Kerkesa e tij eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 per Shoqerite Tregetare dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 per regjistrin tregetar dhe formalitet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare,

VENDOSA

Riregjistrimin e Firmes SICAI Ltd. ne Shoqeri Tregetare SICAI Sh.p.k. dhe miratimin e ndryshimeve e plotesimeve si me poshte :

1. Pranimin e doreheqjes se z.Paolo Bulzacchi si president i firmes SICAI Ltd. dhe largimin e tij si ortak nga kjo firme.
2. Pranimin e doreheqjes se z. Luan Leka si drejtor i firmes SICAI Ltd. dhe largimin e tij si ortak nga kjo firme.
3. Pranimin e z. Plarent Kristo si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 7% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
4. Pranimin e z. Roland Joti si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 7% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
5. Pranimin e z. Thomas Untersteiner (shtetas austriak) si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. me kontribut 34% ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
6. Ndryshimin e kontributit te Z. Grigot Joti ne kapitalin themeltar te Shoqerise SICAI Sh.p.k. nga 33% ne 52%.
7. Ndryshimin e dokumentave baze te firmes ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe riregjistrimin e saj ne organet perkatese me kete objekt veprimtarie :

- Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice.
- Tregetim artikujsh industriale me shumice e pakice.
- Eksport-Import produktesh ushqimore e artikujsh industriale.

15

- Funksionim i nje lokali Bar-Bufe.
- Komisioneri.
- Konsulenca.

Selia e Shoqerise do te jete Rr. Mihal Duri, Nr 17, Tirane.
Jetegjatesia e Shoqerise do te jete 49 vjet.
Emertimi i Shoqerise do te jete si me poshte :
Shoqeria tregetare SICAI Sh.p.k.

Ndryshimet si me siper nuk prekin personalitetin juridik te kesaj Shoqerie Tregetare.

GJYQTARI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 6816/2 Akti

V E N D I M
” I GJYGTARIT TE VETEM”

Sot me date 16.10.2003, ne Tirane une Gjyqtarja Armeta Cefo pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi Z. Plarent Kristo.

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr 6816 date 17.09.2003 eshte rregjistruar si Person Juridik Shoqeria Tregtare ” SICAI” shpk ,me seli ne Tirane , Rr. ”Mihal Duri” , me afat veprimtarie te pa kufizuar, me kapital pre 100,000 (njqindmije) leke te investuar nga ortaket e saj Z. Grigor Joti 52%, Thomas Untersteiner 34%, Plarent Kristo 7% dhe Rolan Joti 7% me objekt veprimtarie si me poshte:
Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice , arikuj industriale si dhe importimin dhe eksportimin e tyre.

Me vendimin Nr.11 date 03.12.2003 (dymije e tre) te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur:

- 1.Miratimi i llogarive (bilancit) perfundimtare te shoqerise te hartuara nga likuiduesi.
- 2.Miratimi i aktit te rregullshmerise se administrimit te shoqerise nga likujduesi.
- 3.Miratimi i heqjes se mandatit Z. Theodharaq Gjoshja si likujdues.
- 4.Llogarite perfundimtare (bilanci i likujdimit), nje kopje e ketij Vendimi si dhe akti i likujdimit te depozitohen prane Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane..

Vendimi i Asamblese eshte noterizuar ne zyren e noterit te Tiranës me Nr. 4401 Rep dhe Nr. 530 Kolek nga noter Dusho Dusho.

P.K.A.

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 ” Per RegjistrinTregtar”

VENDOSA

Depozitim e Kerkeses dhe Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Tregtare ” SICAI ”shpk.


Heqjen e mandatit te likujdues Z.Theodharaq Gjoshja.

Mbylljrn e veprimtarise se shoqerise.

Urdherin e Zyres se Regjistrin Tregtar per te bere ndryshimet perkatese ne kolonen _____.

Ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

GJYQTARE



30

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 6816/1 Akti

V E N D I M
" I G J Y G J T A R I T T E V E T E M "

Sot me date 19.11.2003, ne Tirane une Gjyqtarja Mirë Celo pasi u njoha me materialet e paraqitura nga kerkuesi Z. Plarent Kristo.

K O N S T A T O V A

Se me vendimin Nr 6816 date 17.09.2003 eshte regjistruar si Person Juridik Shoqeria Tregtare " SICAI" shpk ,me seli ne Tirane , Rr. "Mihal Duri" , me afat veprimtarie te pa kufizuar, me kapital pre 100,000 (njqindmije) leke te investuar nga ortakët e saj Z. Grigor Joti 52%, Thomas Untersteiner 34%, Plarent Kristo 7% dhe Rolan Joti 7% me objekt veprimtarie si me poshte:

Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice , arikuj industriale si dhe importimin dhe eksportimin e tyre.

Me vendimin Nr.10 date 25.10.2003 (dymije e tre) te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur:

- Prishjen e se shoqerise duke filluar nga data 01.11.2002.
- Caktimin e Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdator te shoqerise.

Vendimi i Asamblese eshte noterizuar ne zyren e noterit te Tiranes me Nr. 4103 Rep dhe Nr. 474 Kolek nga noter Dusho Dusho.

Keto ndryshime jane pasqyrrar me Vendimin e marre prej Asamblese se Shqerise,e cila se bashku me kerkesen drejtuar Gjykates se Tiranes depozitohet prane Zyres se Regjistrimit Tregtar si dhe Vertetimin e leshuar nga Dega e Tatimeve Nr. 4107 date 28.10.2002.

P.K.A.

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrimin Tregtar"

V E N D O S A

Depozitim e Kerkeses dhe Vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise Tregtare " SICAI" shpk


Prishjen e shoqerise dhe caktimin e Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdator te saj.

Shpalljen e procedurave te likujdimit te shoqerise.

Urdherin e Zyres se Regjistrimit Tregtar per te bere ndryshimet perkatese ne kolonen _____.

Ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.

GJYQTARE



21

**KONRATE THEMELIMI E SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR S.I.C.A.I. Sh.p.k.**

Personat e poshteshenuar qe firmosin kete kontrate:

- z. Grigor Joti, qytetar shqiptar, lindur me 13/02/1956 ne Korce, Shqiperi, me pasaporte EV Nr. 081674, me banim ne Rr. "Ali Baushi", P.7, Sh.7, Ap.65, Tirane.
- z. Plarent Kristo, qytetar shqiptar, lindur me 29/05/1968 ne Tirane, Shqiperi, me pasaporte NF Nr. 474648, me banim ne Rr. "Irfan Tomini", P8/3, Sh.2, Ap.23, Tirane.
- z. Roland Joti, qytetar shqiptar, lindur me 26/08/1961 ne Korce, Shqiperi, me pasaporte EV Nr. 081675, me banim ne Rr. "Ali Baushi", P.7, Sh.7, Ap.65, Tirane.
- z. Thomas Untersteiner qytetar austriak lindur me 19/01/1957 ne Salzburg, Austri, me pasaporte Nr. 28561/92, me banim ne Brucknerstrabe, 6/8, 1040, Vjene.

kane hartuar si me poshte vijon kontraten e themelimit e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre. Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat e statutit bashkengjitur.

Emertimi i Shoqerise eshte S.I.C.A.I. Sh.p.k.

Objekt i veprimtarise se Shoqerise S.I.C.A.I. Sh.p.k. eshte si me poshte :

- Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice.
- Tregetim artikujsh industriale me shumice e pakice.
- Eksport-Import produktesh ushqimore e artikujsh industriale.
- Funkcionim i nje lokali Bar-Bufe.
- Komisioneri.
- Konsulenca.

Selia e Shoqerise eshte Rr. Mihal Duri, Nr.17, Tirane.

Kapitali themeltar eshte me vlere 100000 lek.

Ky kapitali themeltar eshte i perbere nga kontributet e meposhteme ne para :

- z. Grigor Joti kontribon me shumen 52000 (pesedhjet e dy mije) lek ose 52% te kapitalit.
- z. Plarent Kristo kontribon me shumen 7000 (shtate mije) lek ose 7% te kapitalit.
- z. Roland Joti kontribon me shumen 7000 (shtate mije) lek ose 7% te kapitalit.
- z. Thomas Untersteiner kontribon me shumen 34000 (tridhjet e kater mije) lek ose 34% kapitalit.

Kapitali themeltar ndahet ne 100 pjese te barabarta me vlere 1000 (nje mije)lek secili te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100, krejtesisht te shlyera.

z. Grigor Joti merr 52 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 1 deri 52.

z. Plarent Kristo merr 7 pjese te kapitalit themeltar, te renditura

nga numuri i serise 53 deri 59.

Z. Roland Joti merr 7 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 60 deri 66.

Thomas Untersteiner merr 34 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 67 deri 100.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar jane nenshkruar e shlyer krejtesisht, pastaj jane shperndare ndermjet ortakeve si me siper.

Z. Thomas Untersteiner bie dakord qe te kontriboje ne kapitalin e firmes me kuoten e siperpermendur ne kembin te sherbimit qe i kryhet nga z. Plarent Kristo dhe z. Roland Joti per perfaqesimin e tij ne Shqiperi. Fitimi i tij ne Shoqeri do te jete ne forme komisionesh dhe do te percaktohet me ane te kontratave midis ortakeve.

Fitimi neto i realizuar nga Shoqeria qe do te ndahet ndermjet ortakeve si me poshte :

z. Grigor Joti 52% te fitimit

z. Plarent Kristo 24% te fitimit

z. Roland Joti 24% te fitimit

Secili prej ortakeve te ardhshem i ka derdhur z. Roland Joti per llogari te Shoqerise shumen qe i takon sipas nenshkrimt te bere. Derdhjet jane konstatuar nepermjet nje certifikate te nenshkruar nga z. Roland Joti, ku shenon emrat dhe mbiemrat e ortakeve te ardhshem, pjeset e kapitalit themeltar te nenshkruara dhe shumen e derdhur nga secili prej tyre.

Personat qe firmosen me poshte, pasi u njohen me kete certifikate dhe moren nga nje ekzemplar te saj, deklarojne qe shumet e derdhura prej tyre jane ne perputhje me te dhenat e certifikates dhe konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te tyre ne kapitalin themeltar sipas derdhjeve te tyre perkatese. Fillimisht Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem. Administrator i pare i emeruar eshte z. Plarent Kristo per nje mandat 1-vjecar te perseritshem.

Z. Plarent Kristo i jepen te gjitha kompetencat, te cilat pranohen nga ai, me qellim qe te kryeje te gjitha formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Ai gjithashtu ka te drejte te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e tij ne gjykate.

Gjithashtu administratori i emeruar ka mbeshtetjen ligjore te realizoje menjehere aktet dhe angazhimet qe bejne pjese ne objektin e Shoqerise dhe ne kompetencat e tij.

Pas regjistrimit te Shoqerise ne gjykate, keto akte e angazhime do t'i nenshtrohen miratimit nga Asambleja e ortakeve jo me vone se ne mbledhjen per miratimine llogarive te vitit te pare financiar. Ky miratim do te sjelle automatikisht marrjen ne konsiderate nga Shoqeria te akteve dhe angazhimeve te mesiperme.

Kjo kontrate eshte hartuar me date 4 Shtator 1993 ne Tirane, ne 5 (pese) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

(Grigor Joti) (Plarent Kristo) (Roland Joti) (Thomas Untersteiner)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Noteria
Nr. 20270 rep
Nr. 2426 rep

VERTETIM

Sot me date 3 Shtator, 1993 (nentedhjete e tre), ditën e kete qytet, *Armando Sadu L.*, ne zyren e noterise Tirane, para meje, noter ne paraqiten personalisht qytetaret Grigor Joti, Plarent Kristo, Roland Joti, Thomas Untersteiner me gjeneralitete dhe adrese sa me siper. Per identitetin e tyre u sigurova nga leternjofitimet personale, madhore, me zotesi te plote per te kryer veprime juridike te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire statutin sa siper dhe nenshkruan para meje, kurse une noteri e vertetoj ate sipas ligjes rregullisht.




Noter

Armando Sadu L.
Armando

6

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"S.I.C.A.I." Sh.p.k.



Personat e poshteshenuar qe firmosin kete statut

- z. Grigor Joti, qytetar shqiptar, lindur me 13/02/1956 ne Korce, Shqiperi, me pasaporte EV Nr. 081674, me banim ne Rr. "Ali Baushi", P.7, Sh.7, Ap.65, Tirane.
- z. Plarent Kristo, qytetar shqiptar, lindur me 29/05/1968 ne Tirane, Shqiperi, me pasaporte NF Nr. 474648, me banim ne Rr. "Irfan Tomini", P8/3, Sh.2, Ap.23, Tirane.
- z. Roland Joti, qytetar shqiptar, lindur me 26/08/1961 ne Korce, Shqiperi, me pasaporte EV Nr. 081675, me banim ne Rr. "Ali Baushi", P.7, Sh.7, Ap.65, Tirane.
- z. Thomas Untersteiner, qytetar austriak, lindur me 19/01/1957 ne Salzburg, Austri, me pasaporte Nr. 28561/92, me banim ne Brucknerstrabe 6/8, 1040, Vjene.

kane hartuar si me poshte vijon statutin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre.

KAPITULLI I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1
Forma

Ndermjet personave te mesiperm eshte themeluar nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat e ketij statuti.

Neni 2
Emertimi i Shoqerise

Emertimi i Shoqerise eshte "S.I.C.A.I." Sh.p.k.
(me poshte do te referohet si Shoqeri).

Neni 3
Objekti i Shoqerise

Objekt i veprimtarise se Shoqerise "S.I.C.A.I." Sh.p.k eshte si me poshte :

- Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice.
- Tregetim artikujsh industriale me shumice e pakice.
- Eksport-Import produktesh ushqimore e artikujsh industriale.
- Funksionim i nje lokali Bar-Bufe.
- Komisioneri
- Konsulenca

Neni 4
Selia e Shoqerise

Selia e Shoqerise eshte ne Rr. Mihal Duri, Nr.17, Tirane. Transferimi i selise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e ortakëve qe perfitojne mbi 3/4 e pjeseve te fitimit.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria ka kohezgjatje 49 vjet. Ajo mund te riorganizohet ose te priset ne cdo kohe me miratimin e ortakëve qe perfitojne mbi 3/4 e pjeseve te fitimit.

KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte me vlere 100000 lek. Ai eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta me vlere 1000 lek secili te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100, krejtesisht te shlyera.

Fondet e rrjedhura nga shlyerja e pjeseve depozitohen per llogari te Shoqerise ne krijim e siper.

Ne rast rritje te kapitalit nepermjet krijimit te pjeseve te tjera, ortakët kane te drejten e perparise ne nenshkrim proporcionalisht me pjesevet e tyre ne fitim, por ata jane te lire te heqin dore nga kjo e drejte.

Neni 7
Kontributet

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhteme ne para :

- z. Grigor Joti kontribon me shumen 52000 (pesedhete e dy mije) lek ose 52% te kapitalit.
- z. Plarent Kristo kontribon me shumen 7000 (shtate mije) lek ose 7% te kapitalit.
- z. Roland Joti kontribon me shumen 7000 (shtate mije) lek ose 7% te kapitalit.
- z. Thomas Untersteiner kontribon me shumen 34000 (tridhjet e kater mije) lek ose 34% te kapitalit.

Kontributi total eshte 100000 (njeqind mije) lek.

Neni 8
Pjeset e kapitalit themeltar

Ne perputhje me kontributete e dhena ne para te permendura ne nenin e mesiperme :

- z. Grigor Joti merr 52 pjese te kapitalit themeltar, te renditura



8

nga numuri i serise 1 deri 52.

z. Plarent Kristo merr 7 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 53 deri 59.

z. Roland Joti merr 7 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 60 deri 66.

z. Thomas Untersteiner merr 34 pjese te kapitalit themeltar, te renditura nga numuri i serise 67 deri 100.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar nenshkruhen, shlyen plotesisht, pastaj shperndahen ndermjet ortakeve si me siper.

Neni 9

Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen te treteve vetem me miratimin e ortakeve qe perfitojne mbi 3/4 e pjeseve te fitimit dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat ju jane ofruar me pare ortakeve te tjere.

KAPITULLI III

KOPETENCAT E MARRJES SE VENDIMEVE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE

Neni 10

Ortaket dhe Asambleja e ortakeve

Organi vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve. Ortaket e Shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e ketyre vlerave :

z. Grigor Joti 52% te kapitalit themeltar.

z. Plarent Kristo 24% te kapitalit themeltar.

z. Roland Joti 24% te kapitalit themeltar.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese dhe disponon nje numur votash te barabarte me pjeset e fitimit qe ai merr.

Ne ushtrimin e se drejtes se tij per te marre pjese ne vendimet kolektive, cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet vete ose nga nje person tjeter i autorizuar prej tij me shkrim.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe perfitojne mbi 1/10 e pjeseve te fitimit, nga administratori ose likuiduesit. Asambleja mblidhet te pakten nje here ne vit, duke lajmeruar me shkrim ortaket te pakten 15 dite perpara per kohen, vendin dhe rendin e dites se mbledhjes.

Sipas rendesise se veprimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e Zakonshme ose e Jashtezakonshme. Asambleja e Zakonshme vendos per ceshtje te tilla si emertimi apo shkarkimi i administratorit dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimeve.

Asambleja e Jashtezakonshme vendos per ceshtje te tilla si ndryshimet e statutit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar



tek te tretet, riorganizimi apo prishja dhe likuidimi i shoqerise, etj.

Asambleja e Zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme n.q.s jane te pranishem ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe perfitojne mbi 1/2 e pjeseve te fitimit dhe vendimet merren me shumice votash mbi 1/2 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar. N.q.s. mbledhja e pare nuk realizohet, thirrret mbledhja e dyte, e cila mund te marre vendime te vlefshme pavaresisht se sa pjese te fitimit marrin ortaket e pranishem apo te perfaqesuar dhe vendimet merren me shumice votash mbi 1/2 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar. Lajmerimi per thirrjen e mbledhjes se dyte behet me shkrim dhe tregohet vendi, koha dhe rendi i dites se saj. Mbledhja e dyte thirrret jo me shpejt se 15 dite pas dates se caktuar per mbledhjen e pare.

Asambleja e Jashtezakonshme kerkon kushte proceduriale, prezence ose perfaqesimi te njejta me ato te Asamblese te Zakonshme, por ajo merr vendime mbi bazen e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar qe kane mbi 3/4 e fitimit.

Neni 11 Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje administrator qe duhet te jete person fizik dhe mund te jete ortak ne Shoqeri ose jo.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakeve qe perfitojne mbi 1/2 e pjeseve te fitimit. Emerimi i tij behet per nje kohezgjatje prej nje viti financiar me mandat te perseritshem, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem.

Ne marredheniet me ortaket dhe te tretet, administratori ka kompetence per te kryer te gjitha veprimet administrative ne interes te Shoqerise e ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe statuti ja japin shprehimisht Asamblese se ortakeve.

Administratori eshte pergjegjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12 Viti financiar llogarite vjetore

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti i pare financiar perfundon me 31 Dhjetor 1993.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori miratohen nga Asambleja nga ortaket qe perfitojne mbi 1/2 e pjeseve te fitimit.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda

nje afati prej 3 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 13
Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve, ne formen e dividendeve mbi fitimin.

Fitimi qe do te ndahet nepermjet ortakeve, perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur taksat dhe tatimet e ndryshme, shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (jo me pak se 5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vleren 1/10 te kapitalit themeltar), si dhe shumat e nevojshme per mbulimin e humbjeve te mbartura nga vitet e meparshme konform ligjit. Ky fitim ndahet ndermjet ortakeve si me poshte :

- z. Grigor Joti 52 % te fitimit
- z. Plarent Kristo 24 % te fitimit
- z. Roland Joti 24 % te fitimit

Cdo dividend i ndare duke shkelur keto rregulla perben nje dividend fiktiv dhe Shoqeria mund te kerkoje kthimin e tij nga ortaku perfitues brenda nje afati prej 3 vjetesh.

KAPITULLI V

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE,
TERHEQJA NGA SHOQERIA

Neni 14
Prishja

Prishja e Shoqerise behet me kushtet e permendura ne nenin 5 ose per arsyet e parashikuara me ligj.

Neni 15
Terheqja nga Shoqeria

Cdo ortak ka te drejte te terhiqet nga Shoqeria duke paraqitur kerkese me shkrim 6 muaj perpara. Nga ky moment nuk gezon me te drejtat e Shoqerise. Terheqja nuk i liron ortaket nga detyrimet materiale dhe financiare ndaj Shoqerise.

Detyrimet e Shoqerise ndaj ortakut qe largohet likuidohen sipas vendimit te ortakeve qe zoterojne 3/4 pjese te kapitalit themeltar te mbetur (perjashtohet pjesa e kapitalit themeltar te ortakut qe terhiqet), i cili merret jo me vone se 1 vit nga data e paraqitjes se kerkeses per terheqje.

Neni 16
Likuidimi

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone nje ose disa



likuidues, te cilet brenda nje afati prej 6 muajsh i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen aktivitet dhe pasivitet te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit, Asambleja vendos me ortaket qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te fitimit mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi aktin e rregulshmerise se punes se likuidimit dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te krediteve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve me te njejtat proporcione me pjesemarrjen e tyre ne fitime.

KAPITULLI VI

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 17

Marredhenie per punesimin

Kriteret e pergjithshme per punesimin e personave te tjere, numrin e tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e secilit ne Shoqeri percaktohen me miratimin e ortakeve qe perfitojne mbi 1/2 e fitimit.

Punesimi i personave ne Shoqeri kryhet nga administratori mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Kontrata firmoset nga administratori dhe personi i punesuar.

Neni 18

Ruajtja e informacionit

Ortaket dhe te punesuarit jane te detyruar te ruajne ne cdo kohe konfidencialitetin e informacioneve nbi aktivitetin e Shoqerise.

Neni 19

Mosmarrveshjet

Te gjitha mosmarrveshjet midis ortakeve, ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, ndermjet Shoqerise dhe te treteve, etj do te synohet te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert do t'u paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 20

Ky statut eshte hartuar me date 4 Shtator 1993 ne Tirane, ne 5 (pese) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

(Grigor Joti) (Plarent Kristo) (Roland Joti) (Thomas Untersteiner)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Noteria

Nr. 2077/rep

Nr. 7476 rep

VERTETIM

Sot me date 3 Shtator, 1993 (nentedhjete e tre), ditën qytet, ne zyren e noterise Tirane, para meje, noter ne kete qytet, *Armando Ladushi*, u paraqiten personalisht qytetaret Grigor Joti, Plarent Kristo, Roland Joti, Thomas Untersteiner me gjeneralitete dhe adrese sa me siper. Per identitetin e tyre u sigurova nga leternjoftimet personale, madhore, me zotesi te plote per te kryer veprime juridike te cilet deklaruan se kane redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tyre te lire statutin sa siper dhe nenshkruan para meje, kurse une noter i qe vertetoj ate sipas ligjes rregullisht.



Noter

Armando Ladushi
Armando

6816/1

“SICAI” shpk
“Mihal Duri”, Nr 17
Tirane

3 A Copo
19.11.2003
19 NENTOR 2003



Tirane, me 8.11.2003

KERKESE

Objekti: Depozitim vendimi per prishjen e shoqerise dhe caktimin e likujduesit.

**GJYKATES SE SHKALLES PARE TIRANE
REGJISTRIT TREGTAR**

Shoqeria “SICAI” shpk eshte formuar sipas ligjit shqiptar dhe regjistruar me Vendimin Nr. 6816, date 17.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli ne Rrugen “Mihal Duri”, Tirane, objekt Tregeti me shumice dhe pakice import eksport me kapital themelues 100.000 leke.

Me Vendimin Nr.10, date 25.10.2003, asambleja e ortakeve te shoqerise, ka vendosur:

1. Prishjen e shoqerise “SICAI” shpk..
2. Caktimin e Z. Theodharaq Gjoshja si likujdator te shoqerise.

Sa me siper lutemi depozitim e vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise si dhe caktimin e Z. Theodharaq Gjoshja si likujdator te shoqerise konform dispozitave te Ligjit “Per shoqerite tregtare” dhe “Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

Bashkangjitur kesaj kerkese do te gjeni edhe dokumentacionin e me poshtem:
Vendimi e asamblese se ortakeve
Vertetim nga dega e taimeve Nr 4107 date 28.10.2002

Me respekt,

Plarent Kristo
Administrator i Shoqerise

Plarent Kristo

1. Vendimi nr 10
alt 25.10.2003
2. S. regjistruar nr 4107
alt 28.10.2002

REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 4102 Rep.
Nr. 473 Kol




VERTETIM


Sot me date 8 11 2003 (dymije e tre) para meje noteres u paraqit personalisht Z. Plarent Kristo i biri i Sazanit dhe Zhanetes, lindur ne Tirane me 29.05.1968, mbajtes i pashaportes me numer Z0186656, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i njohur personalisht prej meje, i cili me deklaroi se akti i mesiperm eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe ne baze te ligjes nenshkroi para meje noterit.

Une noteri e vertetoj ate konform ligjit.

NOTER



**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"SICAI" shpk**



**Vendim Nr. 10
Date, 25.10.2003**

Sot me daten 25.10.2003, mbeshtetur ne statutin e shoqerise dhe ligjit nr. 7638 date, 19.11.1992 " Per Shoqeriste Tregtare" ne selin e shoqerise u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, me pjesmarjen e plote te antarve te saj te evidentuar si me poshte:

- 1.Grigor Joti
- 2.Thomas Untersteiner
- 3.Plarent Kristo
- 4.Roland Joti

Meqenese ne mbledhje ishin prezent te gjithë antarët dhe plotesohet quorumi i kerkuar,mbledhja eshte e vlefshme te marre ne shqyrtim pikat e meposhteme:

- 1.Prishjen e shoqerise .
 - 2.Caktimin e Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdator te shoqerise.
- Nga diskutimet e antareve rreth kesaj pike , rezulton se shoqeria ka nje periudhe te gjate pa aktivitet dhe nuk ka mundesi per aktivizimin e saj.

Ne perfundim te diskutimeve, Asambleja e Ortakeve:

VENDOSI:

- 1.Prishjen e shoqerise "SICAI" shpk.
- 2.Caktimin e Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdues te shoqerise
3. Likujduesi ka te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga legjislacioni perkates ne fuqi.
- 4.Mandati i tij do te zgjase deri ne perfundimin e plote te likujdimit te shoqerise por asnjehere me shume se limiti ligjor.
5. Meqense nuk kishte me probleme per te diskutuar, mbledhja u deklarua e mbyllur.

Antaret e Asamblese se Ortakeve

Grigor Joti

Plarent Kristo

Roland Joti

Thomas Untersteiner

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE**

Nr. 4103 Rep.

Nr. 1174 Kol



VERTETIM

Sot me date 8 . 11 .2003 (dymije e tre) para meje noterit Jusuf Jusuf u paraqit personalisht:


Z. Grigor Joti i biri i Piros dhe Poliksenit, lindur ne Korçe me 13.02.1956, banues ne Tirane ne: Rr."Hafiz Ibrahim Dalliu, Nr.60, mbajtes i pashaportes me numer 1708368 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. Thomas Untersteiner lindur ne Austri me 19.01.1957, mbajtes i pashaportes me numer 28561/92 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Z. Plarent Kristo i biri i Sazanit dhe Zhanetes, lindur ne Tirane me 29.05.1968, banues ne Tirane ne: "Irfan Tomini" P.8/3, mbajts i pashaportes me numer Z0186656 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Z. Roland Joti i biri i Piros dhe Poliksenit, lindur ne Korçe me 26.08.1961, banues ne Tirane ne: Rr. " Myslym Shyri" K2/19, mbajts i pashaportes me numer 1762199 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identifikimin e te cilive u sigurova nga leternjoftimet personale, te cilit me deklaruan se akti i mesiperm eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe ne baze te ligjes nenshkruar para meje noterit.

Une noteri e vertetoj ate konform ligjit.



20

6816/2



“SICAI” shpk
“Mihal Duri”, Nr 17
Tiran

Tirane, me 13.12.2003

KERKESE

Objekti: Depozitim vendimi per mbylljen e shoqerise.

GJYKATES SE SHKALLES PARE TIRANE REGJISTRIT TREGTAR

Shoqeria “SICAI” shpk eshte formuar sipas ligjit shqiptar dhe regjistruar me Vendimin Nr. 6816, date 17.09.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me seli ne Krugen “Mihal Duri”, Tirane, objekt Tregeti me shumice dhe pakice import eksport me kapital themeltar 100.000 leke.

Me Vendimin Nr.11, date 03.12.2002, asambleja e ortakeve te shoqerise, ka vendosur:

3. TE MIRATOJE llogarite (bilancin) perfundimtare te shoqerise te hartuara nga likuiduesi.
4. TE MIRATOJE aktin e rregullshmerise se administrimit te shoqerise nga likuiduesi.
5. TE MIRATOJE heqjen e mandatit Z. Theodhoraq Gjoshja si likuidues.
EVIDENCIMIN e mbylljes se likuidimit.
6. Llogarite perfundimtare dhe nje kopje te ketij Vendimi te depozitohen prane Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

Sa me siper lutemi depozitim e llogarive perfundimtare te hartuara nga likuiduesi Z. Theodhoraq Gjoshja konform dispozitave te Ligjit “Per shoqerite tregtare” dhe “Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

Bashkangjitur kesaj kerkese do te gjeni edhe dokumentacionin perkates.

Me respekt,

Plarent Kusto
Administrator i Shoqerise

*1. Vendim i asamblejes
2. Akt likuidimi
3. Akt bilancimi
30.11.2003*

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
Nr. 4400 Rep.
Nr. 529 Kol



VERTETIM

Sot me date 13.12.2003 (dymije e tre) para meje noteres u paraqit personalisht Z. Plarent Kristo i biri i Sazanit dhe Zhanetes, lindur ne Tirane me 29.05.1968, mbajtes i pashaportes me numer Z0186656, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar i njohur personalisht prej meje, i cili me deklaroi se akti i mesiperm eshte sipas vullnetit te tij te lire dhe ne baze te ligjes nenshkroi para meje noterit.

Une noteri e vertetoj ate konform ligjit.

NOTER
[Signature]
NOTER
DUSHO DUGHA



**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"SICAI" shpk**

**Vendim Nr. 11
Date, 03.12.03**

Sot me daten 03.12.2003, mbeshtetur ne statutin e shoqerise dhe ligjit nr. 7638 date, 19.11.1992 " Per Shoqeriste Tregtare" ne selin e shoqerise u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, me pjesmarren e plote te antarve te saj te evidentuar si me poshte:

- 1.Grigor Joti
- 2.Thomas Untersteiner
- 3.Plarent Kristo
- 4.Roland Joti

Meqenese ne mbledhje ishin prezent te gjithë antaret dhe plotesohet quorumi i kerkuar,mbledhja eshte e vlefshme te marre ne shqyrtim pikat e meposhteme:

- 1.Miratimin e llogarive (bilancin) perfundimtare te shoqerise te hartuara nga likuiduesi.
- 2.Miratimin e aktit te rregullshmerise se administrimit te shoqerise nga likujduesi.
- 3.Miratimin per heqjen e mandatit Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdues.
EVIDENCIMIN e mbylljes se likujdimit.

Ne perfundim te diskutimeve, Asambleja e Ortakeve:

VENDOSI

- 1.TE MIRATOJE llogarite (bilancin) perfundimtare te shoqerise te hartuara nga likuiduesi.
- 2.TE MIRATOJE aktin e rregullshmerise se administrimit te shoqerise nga likujduesi.
- 3.TE MIRATOJE heqjen e mandatit Z. Theodhoraq Gjoshja si likujdues.
EVIDENCIMIN e mbylljes se likujdimit.
- 4.Llogarite perfundimtare dhe nje kopje e ketij Vendimi te depozitohen prane Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.
- 5.Meqense nuk ka me probleme per te diskutuar , mbledhja u deklarua e mbyllur.

Antaret e Asamblese se Ortakeve


Grigor Joti

Plarent Kristo

Roland Joti

Thomas Untersteiner

29



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE**

Nr. 4401 Rep.

Nr. 530 Kol

VERTETIM

Sot me date 13 .12 .2003 (dymije e tre) para meje noterit Dusho Dusha u paraqit personalisht:

Z. Grigor Joti i biri i Piros dhe Poliksenit, lindur ne Korçe me 13.02.1956, banues ne Tirane ne: Rr."Hafiz Ibrahim Dalliu, Nr.60, mbajtes i pashaportes me numer 1708368 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. Thomas Untersteiner lindur ne Austri me 19.01.1957, mbajtes i pashaportes me numer 28561/92 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Z. Plarent Kristo i biri i Sazanit dhe Zhanetes, lindur ne Tirane me 29.05.1968, banues ne Tirane ne: "Irfan Tomini" P.8/3, mbajts i pashaportes me numer Z0186656 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Z. Roland Joti i biri i Piros dhe Poliksenit, lindur ne Korçe me 26.08.1961, banues ne Tirane ne: Rr. " Myslym Shyri" K2/19, mbajts i pashaportes me numer 1762199 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identifikimin e te cilive u sigurova nga leternjoffimet personale, te cilit me deklaruan se akti i mesiperm eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe ne baze te ligjes nenshkruar para meje noterit.

Une noteri e vertetoj ate konform ligjit.

NOTER
Dusho Dusha
NOTER
DUSHO DUSHA

25

**Shoqeria
“SICAI” Sh.p.k.
Tirane**

**AKT LIKUJDIMI
DHE
BILANCI I LIKUJDIMIT**

**Për mbylljen e shoqerise (likujdimin) me
30. Nentor 2003**

**Likujduesi:
Theodhoraq GJOSHA**

Tirane - 02.Nentor . 2003

AKT- LIKUJDIMI
I
SHOQERISE "SICAI" Sh.p.k.

Me vendim te gjykates se rrethit Tirane nr. 6816, date 17.09.1993 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria " SICAI" Sh.p.k.

Me baze vendim nr. 10, date 25.10.2000 te Asamblese se Ortakeve eshte vendosur prishja e saj dhe caktimi si likujdator z. Theodhoraq Gjosha, banues ne Rr. "Pjeter Bogdani" P.20, Sh.2 Ap. 9D Tirane.

1. Nga dokumentacioni i shoqerise rezulton se kapitali themeltar prej 100,000 leke eshte i ndare ne 100 pjese nga 1000 leke sejcila. Zoteruesit e pjeseve jane ortaket bashkepronare :

-Grigor Joti	52%	ose	52 pjese	52,000 leke
-Thomas Untersteiner	34%	ose	34 pjese	34,000 leke
-Plarent Kristo	7%	ose	7 pjese	7,000 leke
-Roland Joti	7%	ose	7 pjese	7,000 leke

2. Nga bilanci i periudhes 01 Janar 2003 deri me 30. Netor 2003 rezulton:

AKTIVI	100,000 leke
Aktive te qendrueshme	100,000 leke
I.a - Shpenzime te nisjes e zgjerimit	100,000 leke
PASIVI	100,000 leke

27

Kapitalet e veta 100,000 leke
I.a- Kapitali i nenshkruar 100, 000 leke

Duke u nisur nga bilanci sa siper nga ana jone u procedua per likujdimin e shoqerise.

1. U muaren ne dorezim librat dhe dokumentat e shoqerise si dhe bilanci kontabel i llogarive sipas te dhenave te mesiperme te cilat kane sherbyer si pike nisje per operacionet e likujdimit.
2. Operacionet e likujdimit : Mbeshtetur ne dokumentat e paraqitura nga shoqeria u kryen te gjitha veprimet kontabile te nevojshme dhe ne perfundim u perpilua bilanci i likujdimit i cili se bashku me raportin ju bene te njohura Ortakeve te shoqerise.

Bashkangjitur me kete akt likujdimi te shoqerise jane te gjitha veprimet e kryera, nga ana jone per llogari te shoqerise mbeshtetur ne dokumentacionin perkates si dhe bilanci perfundimtar i likujdimit ne te cilin shoqeria paraqitet me nje humbje nga likujdimi prej 100,000 lekesh e cila do te perballohet nga kapitali themeltar prej 100,000 lekesh.

Mbi sa me siper Shoqeria "SICAI" Sh.p.k konsiderohet e likujduar , permbajtja e aktit ju behet e njohur Ortakeve te shoqerise.

LIKUJDATORI

Theodhoro GJOSHA

Tirane me 02.12.2003



28

Shoqeria "SICAI" Sh.p.k (Shoqeri ne likujdim)

Bilanci i dates 31.12.2002 para likujdimit

	Nr	Aktivi	Pasivi
Shpenzime nisje	4	100,000	
Aktive te qendrueshme ne proces	14	0	
Aktive qarkullese Te tjera kerkesa	33	0	
Kapitali	53		100,000
Detyrime Ortake	88		0
TOTALI I BILANCIT		100,000	100,000


Regjistrimet e likujdimit

	Nr.llog		
Anullimi i aktiveve te pashiteshme	6741	0	
Shpenzime te nisjes	201		100,000
Dhenie falas e nxjerrje jashte perdorimit	6745	0	
Dhenie falas e nxjerrje jashte perdorimit	6745	0	
A.Q te trupezuara ne proces	232		0
TVSH e zbritshme	4456		0
Ortake	457	0	
Te ardhura e fitime te tjera	7745		0
Xhirimi i shpenzimeve te likujdimit	647		0
Te ardhura dhe fitime nga likujdimi	774	0	
Rezultat i likujdimit			-100,000
Te ardhura dhe fitime nga likujdimi	774		
Totali		0	0

Shoqeria "SICAI" Sh.p.k (Shoqeri ne likujdim)

Bilanci i dates 30.11.2003 pas likujdimit

	Nr	Aktivi	Pasivi
Kapitali	88		100,000
Rezultat likujdimi			-100,000
TOTALI I BILANCIT		0	0



29

SICAI Sh.p.k. Tirane

6816

Tirane 17.09.1993

te regjistruar
dt. 17.09.1993
977.

K E R K E S E

OBJEKTI : Riregjistrim i Firmes SICAI Ltd., me nr.7947 date 24.09.1992, ne Shoqeri Tregetare SICAI Sh.p.k. dhe riformulim te Statutit.

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

TIRANE

Mbeshtetur ne kerkesat e ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen plotesuar nga Shoqerite Tregetare ", kemi bere disa plotesime te nevojshme me nje riformulim te pergjithshem te statutit te dates 24.09.1992, miratuar nga Ajo Gjykate, me rastin e njohjes se Firmes si person juridik me vendimin nr.7947 date 24.09.1992.

Ne baze te vendimit te dates 31/08/1993 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise SICAI Sh.p.k., qe i eshte bashkengjitur kesaj kerkese, u aprovua :

A.

1. Riformulimi i Statutit ne te cilin Firma SICAI Ltd. emertohet si Shoqeri Tregetare SICAI Sh.p.k.

2. Zgjerim i objektit te veprimtarise se saj si me poshte :

- Tregetim produktesh ushqimore me shumice e pakice.
- Tregetim artikujsh industriale me shumice e pakice.
- Eksport-Import produktesh ushqimore e artikujsh industriale.
- Funkcionim i nje lokali Bar-Bufe.
- Komisioneri.
- Konsulenca.

3. Selia e Shoqerise SICAI. do te jete Rr. Mihal Duri, Nr.17, Tirane.

4. Kapitali i Shoqerise do te jete 100000 leke.

5. Jetegjatesia e Shoqerise do te jete 49 vjet.

B.

1. Doreheqja e z.Paolo Bulzacchi, si president i Shoqerise dhe largimi i tij si ortak ne kete Shoqeri. Qe nga ky moment z.Paolo Bulzacchi nuk eshte me president i Shoqerise. Gjithashtu ai pushon se qeni edhe ortak i Shoqerise.

2

2. Doreheqja e z. Luan Leka nga posti i drejtorit te Shoqerise dhe largimi i tij si ortak ne kete Shoqeri. Qe nga ky moment z.Luan Leka nuk eshte me drejtor i Shoqerise. Gjithashtu ai pushon se qeni edhe ortak i Shoqerise.

3. Pranimin e z. Plarent Kristo si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. Kontributi i tij ne kapitalin themeltar dhe pjesemarja ne fitime percaktohen ne dokumentat baze te Shoqerise.

4. Pranimin e z. Roland Joti si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. Kontributi i tij ne kapitalin themeltar dhe pjesemarja ne fitime percaktohen ne dokumentat baze te Shoqerise.

5. Pranimin e z. Thomas Untersteiner si ortak ne Shoqerine SICAI Sh.p.k. Kontributi i tij ne kapitalin themeltar dhe pjesemarja ne fitime percaktohen ne dokumentat baze te Shoqerise.

Sic permbahet edhe ne artikullin 6 te ligjit 7638 date 19.11.1992, ndryshimet ne Statut nuk ndryshojne personalitetin juridik te Shoqerise Tregetare, prandaj lutemi Asaj Gjykate, mbasi te vertetoje ligjshmerine e kesaj kerkese, te miratoje ndryshimet e mesiperme dhe Statutin e dates 04.09.1993 te kesaj Shoqerie ne vend te Statutit te meparshem te dates 22.09.1992 duke bere dhe ndryshimet perkatese ne Regjistrin Tregetar te Asaj Gjykate.

Ne perputhje me ligjin mbi shoqerite tregetare, dhe me ndryshimet e mesiperme te ortakeve te Shoqerise, kerkohet riregjistrimi i saj prane Gjykates se Tiranes.

Per SICAI Sh.p.k. private
(Administratori)

Plarent Kristo



3